Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen:

a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;

b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formulari i Ofertës, sipas Shtojces 1;

b. Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;

c. Sigurimi i ofertes, sipas Shtojcës 3;

ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;

d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 6;

dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojces 7/1;

e. Deklaratë mbi disponueshmerine e mjeteve sipas Shtojces 7/2;

f. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas Shtojces 8.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:



BASHKIA
TIRANË

“Shërbimi i Pastrimit të Tiranës”

1. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2017, 2018, 2019) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar.
2. Kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore lëshuar nga Autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet të jete jo me e vogel se 40% e fondit limit perkatesisht: **308,990,902** (treqind e tetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë e nëntëqind e dy) lekë pa TVSH.
3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB).

3. Kapaciteti teknik:

1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

Shërbime të së njëjtës natyrë me objektin e prokurimit me vlerë 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **308,990,902** (treqind e tetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë e nëntëqind e dy) lekë pa TVSH, të realizuar gjate tri viteve te fundit.

1.2 Vlerësimi i përvojes së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi per realizimin e shërbimeve;
- Kontratë Shërbimi;
- Faturat tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara/objekti;
- Situacionet për shërbimet e kryera;
- Vërtetim nga fushë depozitimi përkatës mbi depozitimin e mbetjeve.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Vërtetim realizim shërbimi ku të shënohet vlera, koha, objekti i shërbimit të kryer si dhe të percaktohet përqindja e pjesëmarrjes së shërbimit të realizuar në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik;
- Kontrate Shërbimi;
- Faturat tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara/objekti;



BASHKIA
TIRANË

“Shërbimi i Pastrimit të Tiranës”

- Situacionet për shërbimet e kryera;
- Vërtetim nga fushë depozitimi përkatës mbi depozitimin e mbetjeve.

1.3 Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten e bashkimit të operatoreve dhe prokuren e posacme të deklaruar ne fazen e tenderimit.

1.4 Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

2. Një punësim mesatar i të paktën **300 (treqind)** personave, për periudhën **Qershor 2020 – Nëntor 2020** të vërtetuar me:
 - a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen **Qershor 2020 – Nëntor 2020**.
 - b) List-pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen **Qershor 2020 – Nëntor 2020** shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.
3. Çertifikatën ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).*
4. Çertifikatën ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).*
5. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë Çertifikatën OHSAS 18001-2007 / ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën OHSAS/ISO).*
6. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një) punonjës që të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", të shoqëruar me kontratë individuale të punës të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në



BASHKIA
TIRANË

“Shërbimi i Pastrimit të Tiranës”

listëpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit. Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë".

7. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur nga Qendra Kombëtare e Licensimit me:
 - Leje Mjedisore të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për veprimtari që kanë ndikim ndaj mjedisit (për pastrim, larje dhe fshirje rrugësh), (Kodi III.1.A)
 - Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për Ndikimin në Mjedis (kodi III.2.A)
 - Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane (kodi III.2.B)

8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të targa e mjetit dhe sasi të përkatëse për mjetet e mëposhtme:
 - a. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10-12 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **11 (njëmbëdhjetë) copë**;
 - b. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 5-7 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak **1 (një) copë**;
 - c. Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 (një) copë**;
 - d. Makinë vetëshkarkuese e hapura nga sipër, me hapje të spondit anësor ose nga pas, të pajisura me mbulesë, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve vëllimshme dhe të ndërtimit dhe mirëmbajtje të pikave gjatë ditës, etj; me kapacitet transportues 3.5 ton dhe volum vaske jo më të vogël se 5 m³. Viti i prodhimit jo më poshtë se 2010. Jo më pak se **3 (tre) copë**;
 - e. Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 4-6 m³, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 (një) copë**;
 - f. Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10000 litra ujë, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010 jo



BASHKIA
TIRANË

“Shërbimi i Pastrimit të Tiranës”

më pak se **2 (dy) copë**. Të jetë konform normave teknike të Komunitetit European.

9. Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 8, gërma a – f, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:
- a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë) b) leje qarkullimi c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm) e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
 - b) Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi ç) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm) e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
 - c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
 - d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku Autoriteti Kontraktor brenda 5 (pesë) ditëve nga Shpallja e Fituesit, rezervon të drejtën të kryejë verifikim fizik të mjeteve të deklaruara në Shtojcën Nr. 7/2 si dhe te deklarojë adresen e sakte te vendndodhjes se mjeteve në Shqipëri, me qëllim verifikimin e tyre. Nëse pas verifikimit rezulton se Operatori ekonomik i shpallur Fitues nuk i disponon mjetet e deklaruara sipas Shtojcës 7/2, Autoriteti Kontraktor ka të drejtën e s’kualifikimit si dhe do të kalojë tek Operatori ekonomik i kualifikuar, vijues në renditje.
10. Operatori ekonomik duhet të disponojë **1162 copë** konteniere. Disponueshmëria e tyre duhet të vërtetohet me dokumentacionin si më poshtë:
- a) Kontenieret në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar si dhe me faturat tatimore të blerjes.
 - b) Kontenieret e marra me qira duhet të shoqërohen me kontratë qiraje (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata e qerasë duhet të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qera të kontenierëve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi).
 - c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku Autoriteti Kontraktor brenda 5 (pesë) ditëve nga Shpallja e Fituesit, rezervon të drejtën të kryejë verifikim fizik të kontenierëve. Nëse pas verifikimit rezulton se Operatori ekonomik i shpallur Fitues nuk i disponon kontenierët në sasinë e kërkuar, Autoriteti Kontraktor ka të drejtën e s’kualifikimit si dhe do të kalojë tek Operatori ekonomik i kualifikuar, vijues në renditje.



BASHKIA
TIRANË

“Shërbimi i Pastrimit të Tiranës”

- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e konteniereve gjatë gjithë periudhës së kryerjes së shërbimit.
11. Operatori ekonomik duhet të paraqesë metodologjinë e punës për kryerjen e shërbimit të pastrimit sipas Shtojcës 9 të kësaj DST-je, duke iu përmbajtur kërkesave teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.
12. Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e kryerjes së shërbimit të pastrimit sipas afateve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, në Shtojcën 11 të kësaj DST-je.
13. Kandidati, ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Operatorët e huaj ekonomikë duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe, të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe t’i certifikojnë me vulën ”Apostille”. Për vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 05.10.1961 për ”Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj”, duhet të bëhen legalizimet e ketyre dokumentave në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. Mosparaqitja e dokumentacionit në këtë formë është kusht s’kualifikues.
14. Në rastin e moslëshimit në vendin e origjinës të dokumentave të kërkuara sipas kriterëve të mësipërme, ofertuesi duhet të vërtetojë ligjërisht moslëshimin e tyre nga institucione përkatëse të vendit të origjinës.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Loti IV: “Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana IV”

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.



BASHKIA
TIRANË

“Shërbimi i Pastrimit të Tiranës”

- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 7.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formulari i Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*
- c. *Sigurimi i ofertes, sipas Shtojcës 3;*
- ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 6;*



BASHKIA
TIRANË

“Shërbimi i Pastrimit të Tiranës”

dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojces 7/1;

e. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojces 7/2;

f. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas Shtojces 8.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2017, 2018, 2019) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar.
2. Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore lëshuar nga Autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet të jete jo me e vogel se 40% e fondit limit perkatesisht: **362,702,046** (treqind e gjashtëdhjetë e dy milion e shtatëqind e dy mijë e dyzetë e gjashtë) lekë pa TVSH.
3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB).

3. Kapaciteti teknik:

1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

Shërbime të së njëjtës natyrë me objektin e prokurimit me vlerë 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **362,702,046** (treqind e gjashtëdhjetë e dy milion e shtatëqind e dy mijë e dyzetë e gjashtë) lekë pa TVSH, të realizuar gjate tri viteve te fundit.

1.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:



BASHKIA
TIRANË

“Shërbimi i Pastrimit të Tiranës”

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vleresimi per realizimin e shërbimeve;
- Kontratë Shërbimi;
- Faturat tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara/objekti;
- Situacionet për shërbimet e kryera;
- Vërtetim nga fushë depozitimi përkatës mbi depozitimin e mbetjeve.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Vërtetim realizim shërbimi ku të shënohet vlera, koha, objekti i shërbimit të kryer si dhe te përcaktohet përqindja e pjesëmarrjes së shërbimit të realizuar në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik;
- Kontrate Shërbimi;
- Faturat tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara/objekti;
- Situacionet për shërbimet e kryera;
- Vërtetim nga fushë depozitimi përkatës mbi depozitimin e mbetjeve.

1.3 Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten e bashkimit të operatoreve dhe prokuren e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit.

1.4 Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

2. Një punësim mesatar i të paktën **300 (treqind)** personave, për periudhën **Qershor 2020 – Nëntor 2020** të vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën **Qershor 2020 – Nëntor 2020**.
- b. List-pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Qershor 2020 – Nëntor 2020** shoqëruar me formularet e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

3. Çertifikatën ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *(Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).*



BASHKIA
TIRANË

“Shërbimi i Pastrimit të Tiranës”

4. Çertifikatën ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).*
5. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë Çertifikatën OHSAS 18001-2007 / ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën OHSAS/ISO).*
6. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një) punonjës që të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", të shoqëruar me kontratë individuale të punës të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit. *Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë".*
7. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur nga Qendra Kombëtare e Licensimit me;
 - Leje Mjedisore të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për veprimtari që kanë ndikim ndaj mjedisit (për pastrim, larje dhe fshirje rrugësh), (Kodi III.1.A)
 - Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për Ndikimin në Mjedis (kodi III.2.A)
 - Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane (kodi III.2.B)
8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të targa e mjetit dhe sasi të përkatëse për mjetet e mëposhtme:
 - a) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10-12 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **13 (trembëdhjetë) copë;**
 - b) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 5-7 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak **2 (dy) copë;**



BASHKIA
TIRANË

“Shërbimi i Pastrimit të Tiranës”

- c) Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 (një) copë**;
 - d) Makinë vetëshkarkuese e hapura nga sipër, me hapje të spondit anësor ose nga pas, të pajisura me mbulesë, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve vëllimshme dhe të ndërtimit dhe mirëmbajtje të pikave gjatë ditës, etj; me kapacitet transportues 3.5 ton dhe volum vaske jo më të vogël se 5 m³. Viti i prodhimit jo më poshtë se 2010. Jo më pak se **5 (pesë) copë**;
 - e) Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 4-6 m³, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010, jo më pak se **1 (një) copë**;
 - f) Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10000 litra ujë, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010 jo më pak se **2 (dy) copë**. Të jetë konform normave teknike të Komunitetit Europian.
9. Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 8, gërma a – f, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:
- a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë) b) leje qarkullimi c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm) e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
 - b. Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi ç) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm) e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
 - c. Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
 - d. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku Autoriteti Kontraktor brenda 5 (pesë) ditëve nga Shpallja e Fituesit, rezervon të drejtën të kryejë verifikim fizik të mjeteve të deklaruara në Shtojcën Nr. 7/2 si dhe të deklarojë adresën e sakte të vendndodhjes së mjeteve në Shqipëri, me qëllim verifikimin e tyre. Nëse pas verifikimit rezulton se Operatori ekonomik i shpallur Fitues nuk i disponon mjetet e deklaruara sipas Shtojcës 7/2, Autoriteti Kontraktor ka të drejtën e s’kualifikimit si dhe do të kalojë tek Operatori ekonomik i kualifikuar, vijues në renditje.
-



BASHKIA
TIRANË

“Shërbimi i Pastrimit të Tiranës”

- 10.** Operatori ekonomik duhet të disponojë **1532 copë** konteniere. Disponueshmëria e tyre duhet të vërtetohet me dokumentacionin si më poshtë:
- a.** Kontenieret në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie original ose kopje të noterizuar si dhe me faturat tatimore të blerjes.
 - b.** Kontenieret e marra me qira duhet të shoqërohen me kontratë qiraje (original ose kopje e noterizuar). Kontrata e qerasë duhet të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qera të konteniereve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi).
 - c.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku Autoriteti Kontraktor brenda 5 (pesë) ditëve nga Shpallja e Fituesit, rezervon të drejtën të kryejë verifikim fizik të konteniereve. Nëse pas verifikimit rezulton se Operatori ekonomik i shpallur Fitues nuk i disponon kontenierët në sasinë e kërkuar, Autoriteti Kontraktor ka të drejtën e s’kualifikimit si dhe do të kalojë tek Operatori ekonomik i kualifikuar, vijues në renditje.
 - d.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e konteniereve gjatë gjithë periudhës së kryerjes së shërbimit.
- 11.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë metodologjinë e punës për kryerjen e shërbimit të pastrimit sipas Shtojcës 9 të kësaj DST-je, duke iu përmbajtur kërkesave teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.
- 12.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e kryerjes së shërbimit të pastrimit sipas afateve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, në Shtojcën 11 të kësaj DST-je.
- 13.** Kandidati, ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Operatorët e huaj ekonomikë duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe, të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe t’i certifikojnë me vulën ”Apostille”. Për vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 05.10.1961 për ”Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj”, duhet të bëhen legalizimet e këtyre dokumentave në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. Mosparaqitja e dokumentacionit në këtë formë është kusht s’kualifikues.
- 14.** Në rastin e moslëshimit në vendin e origjinës të dokumentave të kërkuara sipas kriterëve të mësipërme, ofertuesi duhet të vërtetojë ligjërisht moslëshimin e tyre nga institucione përkatëse të vendit të origjinës.



BASHKIA
TIRANË

“Shërbimi i Pastrimit të Tiranës”

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 9

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Bashkangjitur Dokumentave Standarte të Tenderit.



BASHKIA
TIRANË

“Shërbimi i Pastrimit të Tiranës”

Shtojca 10

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

PLANIFIKIMI I KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

<input type="checkbox"/> Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____



BASHKIA
TIRANË

“Shërbimi i Pastrimit të Tiranës”

Shtojca 11

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: *“Shërbimi i Pastrimit të Tiranës”*, i ndarë në lote:

- **Loti I:** *“Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana I”*;
- **Loti II:** *“Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana II”*;
- **Loti III:** *“Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana III”*;
- **Loti IV:** *“Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana IV”*.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Afati maksimal i realizimit të shërbimit do të jetë 3-vjecar. Operatorët ekonomik të shpallur fitues (per secilin Lot) do të rinovojnë kontratat objekt të kësaj Marrëveshje Kuadër çdo 1 (një) vit.

Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër: jo më shumë se 4 (katër) vjet.

Shtojca 12

TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: *“Shërbimi i Pastrimit të Tiranës”*, i ndarë në lote:

- **Loti I:** *“Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana I”*;
- **Loti II:** *“Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana II”*;
- **Loti III:** *“Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana III”*;
- **Loti IV:** *“Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana IV”*.

Detyrat për secilin Lot: Bashkangjitur Dokumentave Standarte të Tenderit.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Zonat sipas Hartës Bashkëlidhur DST sipas secilit Lot.



BASHKIA
TIRANË

“Shërbimi i Pastrimit të Tiranës”

Shtojca 13

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁴

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

⁴ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore



BASHKIA
TIRANË

“Shërbimi i Pastrimit të Tiranës”

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

Shtojca 14

[Shtojcë për t’u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data_____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*



BASHKIA
TIRANË

“Shërbimi i Pastrimit të Tiranës”

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]



BASHKIA
TIRANË

“Shërbimi i Pastrimit të Tiranës”

Shtojca 15

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____

2. _____

3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*



BASHKIA
TIRANË

“Shërbimi i Pastrimit të Tiranës”

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)



BASHKIA
TIRANË

“Shërbimi i Pastrimit të Tiranës”

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj.____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

KUSHTET E PËRGJITHSHME TE KONTRATES Shërbimet – Procedura e Hapur

Neni 1 Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Shërbimeve të prokuruarra me anë të procedurës së hapur.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit

Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.

- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

Kushtet e kontratës, përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2 Përkufizime

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.



BASHKIA
TIRANË

“Shërbimi i Pastrimit të Tiranës”

2.8 “Termat e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

Neni 3 Hartimi i Kontratës

- 3.1 Shpallja e fituesit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke materializuar të gjitha marrëveshjet midis palëve.

Neni 4 Praktikrat Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

